REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# V E N D I M

Nr. 222 datë 24.5.1997

PËR

## MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME KONCESION TË FORMËS "B.O.T." PËR HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe të Ministrisë së Burimeve Minerare e Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të miratojë marrëveshjen e lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministrisë së Burimeve Minerare e Energjetike dhe shoqërisë italiane B.E.G. SpA për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit me koncesion të formës "B.O.T.", me përjashtim të neneve 8, 10, 24, 25, 30.

2. Shpronësimet e kupës së liqenit deri në kuotën 110 m mbi nivelin e detit dhe të zonës ku do të ndërtohet hidrocentrali i Kalivaçit në përputhje me planorganizimin dhe projektin e veprave [illegible] nga Këshilli i Rrethit të Tepelenës në përputhje me ligjin nr.7848, datë 25.7.1994 "Për shpronësimet më interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme".

3. Financimi i shpronësimeve të pronave private do të përballohet nga shoqëria italiane B.E.G. SpA.

4. Të autorizojë shoqërinë B.E.G. SpA për të kryer me shpenzimet e saj studimin e bashmërisë të hidrocentraleve të pjesë së poshtme të lumit Vjosë, mbas hidrocentralit të Kalivaçit.

Në rast se do të rezultojë nga studimi e do të miratohet nga Qeveria, ndërtimi i ndonjë hidrocentrali tjetër me koncesion të formës "B.O.T.", B.E.G. SpA ka të drejtën të jetë negociatori i parë.

5. Koncesionari lejohet të përdorë gratis materialet rrethanore në zonat demaniale dhe të hapë karriera për prodhim inertesh dhe argjilash në periudhën e ndërtimit të impiantit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
EKREM KASTRATI

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
BASHKIM FINO

Nr.prot.1075/1
datë 2.6.1997

PRESIDENCËS - KUVENDIT POPULLOR
GJYKATËS KUSHTETUESE - GJYKATËS SË KASACIONI
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TURIZMIT
MINISTRISË SË BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKE
MINISTRISË SË FINANCAVE
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË SHTETIT

TIRANË

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
EKREM KASTRATI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Dhoma Noterisë TIRANË
Nr 1544 D. 31 Mars 2000
VËRTETIM
Vërtetohet njësia me
ORIGJINALIN